



# Shpresë Siqeca

BOTA MAGJIKE  
E QILIMAVE TË PRIZRENIT

MAGIC WORLD  
OF PRIZREN CARPETS





# Shpresë Siqeca

BOTA MAGJIKE  
E QILIMAVE TË PRIZRENIT

MAGIC WORLD  
OF PRIZREN CARPETS

**Gjeçovi - Prizren, 2012**

© Të drejtat e rezervuara-All rights reserved

Redaktor dhe Korrektor - Editor and Reviser:  
Besa Berisha

Fotografitë - Photos:  
Autori - Author  
Menduh Nushi

Katalogu u mbështetë financiarisht nga:  
This catalogue is sponsored by:



## Parathënie

Ekspozita “Bota magjike e qilimave të Prizrenit” prezanton 200 fotografi dokumentare të cergave, qilimave dhe përparëseve të rajonit të Prizrenit. Për qëllime krahasimtare, janë marrë në shqyrtim qilimat e vendeve të tjera si të Republikës së Maqedonisë dhe të Shqipërisë. Ekspozita prezanton 20 modele të ndryshme të qilimave, prej të cilëve artizanë të shkathtë mundë të punojnë çanta, kuleta dhe suvenire.

Qëllimi i ekspozitës është ngritja e ndërgjegjes së shoqërisë civile për pjesëmarrjen aktive në ruajtjen dhe promovimin e qilimave të rajonit të Prizrenit.

Objektivi i ekspozitës është krijimi i biznesit të punimit të qilimave në Prizren, i cili është faktor i qëndrueshëm për zhvillimin e etno turizmit.

Ekspozita hapet për nder të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane -2012.

Donator i ekspozitës është: Fondacioni Suedez: Trashëgimia Kulturore pa Kufij - zyra në Kosovë.

## Preface

Exhibition “Magic World of Prizren Carpets” presents 200 documentary photos of rugs, carpets and aprons from Prizren Region. Due to comparison aims, carpets from other places such as Republic of Macedonia and Albania will be presented for discussion. Exhibit presents 20 diverse models of carpets from which skilful craftsmen can make purses, wallets and souvenirs.

The aim of the exhibition is to increase the thoroughness of civil society in active participation in preserving and promotion of carpets of Prizren Region.

The objective of the exhibition is to establish the business of carpet manufacturing in Prizren, which is as a sustainable factor toward development of Ethno-Tourism.

Exhibition will be opened on honor of European Heritage Days 2012.

Donator of the Exhibition is Sweden Foundation: Cultural Heritage without Borders- Kosovo office.

## I. QILIMAT E KOMUNËS SË PRIZRENIT

Qilimat, cergat dhe sixhadetë u evidencuan në shtëpitë private si dhe në xhamitë e Prizrenit dhe të fshatrave të Komunës së tij.

Qilimat, cergat dhe sixhadetë janë endur kryesisht prej leshi. Shumica e tyre i përkasin fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX.

Cergat janë endur me lesh dhije. Ato janë të zbukuruara me vija në drejtim horizontal me gjerësi të njëjtë apo të ndryshme. Disa kanë ngjyrë të zezë, të bardhë, të përhimë, të kuqe, ngjyrë krem e ngjyrë kafeje. Të tjerat kanë ngjyrë të kuqe, të verdhë, të gjelbër e të bardhë.

Qilimat e Prizrenit janë prej leshit të endur me një fletë pëlhure. Trualli i tyre është kryesisht me ngjyrë të kuqe e më pak me ngjyrë të zezë e me ngjyra të tjera. Ata kanë një ose dy bordura me ngjyra dhe stolisje të tjera. Përmasat e tyre janë 4 x 4 m. ose 4 x 3, 5 m.

### A. Qilima me dominimin e motiveve zoomorfe

Disa qilima të endur prej leshit zbukurohen me motivin e shqiponjës. Sfondi qendror i tyre kryesisht është me ngjyrë të kuqe, kurse bordura me ngjyrë të zezë. Në ndonjë qilim sfondi nga bordura ndahet me vija të trasha të bardha. Motivi qendror i sfondit është vetëm shqiponja e stilizuar ose në mes të motiveve

me shqiponjë ka motive të stilizuara florale apo gjeometrike, të endura me ngjyrë të bardhë dhe të përhimë. Shqiponja është me ngjyrë të zezë ose ka pak kombinime me ngjyrë të bardhë dhe të përhimë.

Motivet e shqiponjës janë të shkëputura dhe të radhitura në linjën vertikale. Bordura ka motive gjeometrike të vargëzuara në mënyrë simetrike në mes vete ose ornamente florale të stilizuara.

Qilima me këtë motiv janë gjetur në xhaminë e Gazi Mehmet Pashës dhe në disa shtëpi private.

Në rajonin e Hasit të Prizrenit qilimat dhe strukat me motivin e shqiponjës kryesisht truallin e kanë me ngjyrë të kuqe, ndërsa bordurën me ngjyrë të zezë. Në këto tekstile motivi i shqiponjës paraqitet në formë natyrore dhe të stilizuar.

Në rajonin e Vrrinit qilimat /“qylymat”/ enden prej leshit, kryesisht me truall me ngjyrë të kuqe dhe ornamente me ngjyrë të zezë. Sixhadetë enden prej leshit apo leshit të kombinuar me pambuk. Ato enden me dy fletë pëlhure dhe kanë thekë në të dy anët. Qilimat dhe sixhadet

zbukurohen me motivin e shqiponjës që i quajnë “me balanga” ose “yrnek me shqipe.” Në bordura “qemer” ato kombinohen me motive florale që i quajnë

“lul - mollë”, sepse motivet i ngjajnë mollës. Motivi i



shqiponjës paraqitet në mesin e qilimit ose të sixhadesë dhe quhet "tablla e midisit", ndërsa motivet në skaje quhen "tablla e skajit."

Qilimat dhe tekstilet e tjera me motivin e shqiponjës janë punuar në tërë rajonin e Rrafshit të Dukagjinit, sidomos në Pejë, si dhe në rajonet e tjera të Kosovës. Në disa qilima gjejmë motivin e skematizuar të gjarprit në formë të spirales e të vijave zigzage. Këta qilima i gjejmë në rajonin e Hasit të Prizrenit, të Zhupës etj.

Edhe në qilimat e Prizrenit me rrethinë, si dhe në përgjithësi në qilimat shqiptarë, paraqitet motivi i bretkosës, të cilin e quajnë motivi i "zhabës". Qilima me këtë motiv i gjejmë në Zhur të rajonit të Lumës, si dhe në fshatrat e rajonit të Hasit të Prizrenit, ku gjejmë edhe motivin e dallëndysheve dhe të zogjve në formë natyrore, që i quajnë "kabruza me kaçagremça."

### **B. Qilima me motive gjeometrike**

Disa qilima, mbulesat e djepit dhe tekstilet e tjera të rajonit të Prizrenit, zbukurohen me motivin e rombit. Këta qilima njihen sipas emrit të motivit si qilima "me topa."

Në një variant qilimat me këtë motiv truallin e kanë me ngjyrë të kuqe, ndërsa ornamentet me ngjyrë të bardhë, të zezë, të kaltër e ngjyrë portokalli. Në truallin e qilimit paraqiten motivet e rombeve të

stilizuara. Ato janë të radhitura në mënyrë simetrike, me një romb të madh në mes e nga një romb të vogël në katër cepa të tij. Këto rombe janë të rrethuara me rombe të vogla, gjithashtu të stilizuara. Këta qilima kanë dy bordura. Bordura e brendshme truallin e ka me ngjyrë të zezë, ndërsa ajo e jashtme me ngjyrë të kuqe. Të dy bordurat kanë zbukurime të ndryshme nga njëra tjetra. Në to paraqitet motivi i shqiponjës së stilizuar dhe rombe të vogla.

Një qilim me këtë motiv ruhej deri në vitin 1999 në Konakun e Shuaip Spahiut.

Një variant i ngjashëm është gjetur në Xhaminë e Ademajve në Zhur të rajonit të Lumës.

Ekzemplarët e tjerë të qilimave prizrenas me këtë motiv truallin e kanë me ngjyrë të zezë, ndërsa stolisjet me ngjyrë të bardhë, të kuqe e të kaltër. Në truallin e qilimit paraqiten motivet e rombeve të dhëmbëzuara. Ato janë të radhitura në varg, në linjën vertikale, në tërë sipërfaqen e tij. Qilimi e ka bordurën me ngjyrë të kuqe dhe motive zbukuruese me ngjyrë të bardhë, të kaltër e të verdhë. Anëve rrethohet me një shirit me ngjyrë të zezë.

Variantet e tjera të qilimave të Kosovës, me këtë motiv, truallin e kanë me ngjyrë të kuqe. Në truallin e qilimit paraqiten motivet e rombeve dhe të shqiponjave të stilizuara. Ato janë të lidhura në varg

në linjën vertikale, në tërë fushën e tij. Këta qilima kanë dy bordura me ornamente të stilizuara të shqiptarëve dhe ornamente të tjera. Bordurat rrethohen dhe ndahen në mes vete me një varg rombesh të vogla.

Në disa qilima të tjerë të Kosovës të cilët përdoren në qytetet e Kosovës dhe në qytetet shqiptare të Maqedonisë, në tërë fushën ka zbukurime të ndara në blloqe në linjë horizontale. Në mes të tyre janë blloqet me zbukurime të tjera. Një qilim i këtij varianti ka katër blloqe dhe stolisje në formë të rombit, ndryshe nga njëra-tjetra. Blloqet e tjera zbukurohen me rombe të vogla. Trualli i bordurës është me ngjyrë të përhimë, ndërsa zbukurimet janë me ngjyrë të kaltër, të kuqe të mbyllët e të verdhë. Një qilim me këtë motiv, i cili është punuar në fillim të shekullit XX, është gjetur në shtëpinë e shejh Nexhat Shehut të radhës Halveti. Qilima të ngjashëm, por me ngjyra të tjera /me truallin me ngjyrë të kuqe/, i kemi ndeshur në disa shtëpi të qyteteve shqiptare të Maqedonisë.

Në rajonin e Hasit të Prizrenit disa qilima, sixhade, jastëkë leshi, struka dhe shoka të djepit kanë motive gjeometrike të kombinuara me motive florale në formë të luleve me shumë ngjyra. Motivet gjeometrike janë në formë të katrorëve dhe të rombeve të stilizuara “me topa”.

Në rajonin e Podgurit të Prizrenit enden qilima dhe përparëse prej leshi. Trualli është përgjithësisht me ngjyrë të kuqe, ndërsa zbukurimet me ngjyra të ndryshme. Zbukurohen me ornamente gjeometrike në formë të rombeve.

Në rajonin e Zhupës enden qilima të vegjël kryesisht me ngjyrë të kuqe. Motivi më i shpeshtë është ai i rombit të stilizuar, por ka edhe motive të imëta florale etj.

Qilima me motive gjeometrike punohen në tërë rajonin e Rrafshit të Dukagjinit, me qendër në Pejë.

### C. Qilima me motive florale

Motivet florale shpesh i shoqërojnë sfondet e sidomos bordurat e qilimave dhe të tekstileve prizrenase. Në ndonjërin prej tyre ai është motiv qendror.

Një qilim, i cili është gjetur në Konakun e Shuaip Spahiut, e ka sfondin me ngjyrë të kuqe, ndërsa zbukurimet në formë lulësh me ngjyrë të zezë.

Në Prizren dhe në ndonjë fshat afër Prizrenit janë përdorur qilimat me motive të mëdha florale të punuara mbi një bazë me ngjyrë të kuqe ose të zezë. Qilima me këto motive punohen kryesisht në Pejë dhe në viset shqiptare të Malit të Zi.

Në rajonin e Hasit të Prizrenit disa struka dhe jastëkë leshi kanë vetëm motive florale në formë të luleve, të

punuara me penj leshi shumëngjyrësh.

Në Zhur dhe Vërmicë të rajonit të Lumës u evidencuan disa qilima, të cilët kanë vetëm motive florale. Ata e kanë truallin me ngjyrë të kuqe dhe dy bordura me ngjyra të tjera. Në tërë sipërfaqen qilimat kanë motive florale që i quajnë "lul - molla." Disa sixhade kanë motive florale si në truall ashtu edhe në bordura. Sixhadetë e tjera kanë motive florale të kombinuara me ato gjeometrike. Ato e kanë truallin me ngjyrë çiklamin dhe tre bordura me ngjyra të ndryshme. Trualli është i zbukuruar në qendër me një motiv të madh floral dhe katër motive gjeometrike.

#### **D. Qilima dhe sixhade me motive fetare**


Në sixhadetë e rajonit të Lumës hasim motive fetare. Këto sixhade, të cilat shërbejnë për falje, e kanë në mes motivin e apsidës së xhamisë /mihrabi/. Trualli rrethohet me bordura që kanë motive florale e gjeometrike.

#### **Dh. Qilima me motive të tjera**

Në rajonin e Hasit të Prizrenit, në qilima, struka dhe jastëkë leshi gjejmë motivet e hajmalisë, të krahnit, të këmbanës, të iksit etj.

Në fshatin Gënçar të rajonit të Podgurit të Prizrenit, gratë akoma endin në vek, ndërsa në disa fshatra, si p.sh. në Korishë, gratë nuk endin dhe nuk mund të gjendet veku.

Sot gratë e disa fshatrave të Zhupës si Lubinja e Epërme, Jablanica, Manastirica etj. endin në vek qilima dhe sixhade me motive karakteristike të këtij rajoni. Në Reçan çdo vit organizohet Panairi i artizanateve dhe i ushqimeve tradicionale, ku gratë e këtyre trevave i ekspozojnë dhe i shesin prodhimet e tyre.



## II. QILIMAT E KOMUNËS SË DRAGASHIT

### 1. QILIMAT E RAJONIT TË OPOJËS

Në rajonin e Opojës janë evidencuar qilima, sixhade, struka “dyshemetë e djepit” etj. Këto tekstile gjenden nëpër shtëpi private dhe në ndonjë xhami.

Në Bresanë, Brrut të Madh dhe në fshatra të tjerë qilimat enden prej leshit, me kombinimin e ngjyrës së kuqe dhe të zezë. Motivet në formë të topave i quajnë “lulat e qylymit“. Ndërkaq sixhadetë zbukurohen me ornamente florale - lule. Strukat “dyshemetë” e djepit enden prej mëndafshit dhe zbukurohen “larohen“ në dy bordura me motive

gjeometrike e florale.

Në rajonin e Opojës, aty - këtu, mund të gjenden vegla për punimin e tekstileve prej lini, leshi dhe pambuku. Këtu gjejmë krehër, furka për punimin e leshit dhe të linit, vekun, shtjellcin, shtizën e boshtin për punimin e leshit e të pambukut etj. Në të kaluarën veku është përdorur shumë, ndësa sot, aty këtu, ndonjë grua end në vek.

## 2. QILIMAT E RAJONIT TË GORËS

Dhomat e shtëpive si dhe disa xhami dhe tyrbe të rajonit të Gorës janë të shtruara me qilima dhe me sixhade tradicionale të këtij rajoni. Ato janë të endura në vek. Kanë dimensione të vogla. Ngjyra karakteristike janë: e verdhë, ngjyrë kungulli dhe ngjyra e kuqe. Ornamentet janë florale /lule, gjethe, fletë/, gjeometrike /rombe në madhësi të ndryshme/, zoomorfe /zogj, peshq, flutura/.




## III. QILIMAT E KOMUNËS SË SUHAREKËS

Hulumtimet për qilimat dhe sixhadetë e komunës së Suharekës janë bërë në vitin 2003 në Leshan, Gurrë, Vneshtar, Semetisht etj.

Në fshatrat e kësaj komune enden qilima prej leshit

me ngjyra të ndryshme. Ata kryesisht e kanë truallin e kuq me motive të zeza dhe bordurën e zezë me motive të kuqe. Në dy skaje, në fund, kanë vija të gjera të kuqe e të zeza. Në truallin e një qilimi të evidencuar në Leshan, paraqiten motive gjeometrike me ngjyra të ndryshme, ndërsa në bordura motive zoomorfe me ngjyra kuqezi. Një qilim tjetër është i endur prej leshit me ngjyra të ndryshme, me motive gjeometrike në formë të trekëndëshit, të rombeve të dhëmbëzuara etj. Në Semetisht janë evidencuar qilima me motivin e shqiponjës dhe të rombeve. Në xhaminë e Vneshtarit ndodhen disa qilima dhe sixhade të cilat kanë ornamente florale.

Në Komunën e Suharekës përpara ka pasur vekë, por tani ato shumë rrallë gjenden dhe gratë shumë rrallë endin. Vekët, furkat dhe shtizat janë shkatërruar në luftën e fundit në Kosovë, në vitet 1998-99.





#### IV. QILIMAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Në fshatrat e Komunës së Rahovecit enden qilima, cerga dhe sixhade me motivin e shqiponjës “me balona”. Qilimat /“qylym”/ me këtë motiv enden prej leshit, me truallin me ngjyrë të kuqe dhe bordurën me ngjyrë të zezë. Motivet e shqiponjës punohen me ngjyrë të zezë në truallin e kuq të qilimit.

Në qilima të kësaj komune gjejmë motive të rombeve “me topa” dhe motive florale që i quajnë “lula-lula”. Qilimat kanë edhe motive “me vargje”. Ndërsa në sixhade paraqiten motivet fetare.

Nga veglat për punimin e qilimave janë evidencuar vekët, çikriku dhe shtjellci.



#### V. QILIMAT E KOMUNËS SË MALISHEVËS

Qilimat e fshatrave të Komunës së Malishevës janë prej leshit, të endur në vek me tre ose katër fletë pëlhure. Truallin e kanë kryesisht me ngjyrë të kuqe, ndërsa bordurën me ngjyrë të zezë. Janë të ornamentuar me motive florale shumëngjyrëshe, që

shtrihen në tërë sipërfaqen e qilimit dhe me motivin e rombeve. Qilima me këto motive u evidencuan në Bellanicë dhe Banjë. Në qilima të tjerë kuqezi përdoret motivi i shqiponjës. Qilima me këtë motiv u evidencuan në Carrallukë, Damanek etj.


Janat janë të endur prej leshit të dhive. Truallin e kanë me ngjyrë të kuqe. Zbukurohen me motive florale shumëngjyrëshe, si në truall, ashtu edhe në bordura.

Ato shtrihen mbi shilte. Janet u evidencuan në Bellanicë.

Mbulesat e krevatit, "dekicat", janë të endura në vek dhe skajeve kanë thekë. Në mes dhe në skaje ato rrethohen me motive të mëdha florale. Mbulesat e krevatit u evidencuan në Qupevë të Damanekit. Mbulesat e djepit /"strukat"/ janë të endura në vek prej leshit ose pambukut cilësor "bogosi". Ndonjëra prej strukave të punuara prej pambukut, është endur në formë katrorësh me ngjyrë të bardhë e të kuqe.


Duqit janë të endur prej leshi ngjyrë kungulli ose ngjyrë të kuqe. Kanë dy xhepa me ngjyrë të zezë, të ornamentuar me motivin e kryqit dhe me motive florale e gjeometrike /rombe, katrorë/.

Vekët shumë rrallë gjenden dhe pothuajse fare nuk përdoren sot. Aty - këtu është evidencuar ndonjë shtizë, bosht, furkë për tjerren e leshit etj. Në muzeun e shkollës së Tërpezës ndodhen pjesët e vekut: një drugëz e vogël dhe një e madhe, shpata, çekërku dhe gërhana /kërhana/ për krehjen e lirit.




Qilima të endur, Prizren


Woven carpets, Prizren



Qilim i endur, Prizren  
Woven carpet, Prizren




Qilim i endur, rajoni i Lumës  
Woven carpet, region of Luma





Qilim i endur, rajoni i Zhupës  
Woven carpet, region of Zhupa




Përparëse e grave, varianti katolik, Zym, rajoni i Hasit të Prizrenit  
Women apron, Catholic version, Zym, region of Has of Prizren





Përparëse e grave, varianti katolik, Zym, rajoni i Hasit të Prizrenit  
Women apron, Catholic version, Zym, region of Has of Prizren




Qilim, Opoja  
Woven carpet, Opoja



Qilima, Gorë  
Woven carpets, Gora



Qilim, Malishevë  
Woven carpet, Malisheva



Qilim,  
Suharekë  
Woven  
carpet,  
Suhareka



## PËRFUNDIM

Punimi i qilimave është një traditë e njohur e artizanatit shtëpiak prizrenas. Në vitet '60 të shekullit XIX, në Prizren, përhapje të gjerë kishte marrë punimi i qilimave të leshit. Në fillim të shekullit XX në Prizren ka ekzistuar shkolla e punëdoreve ku, pos aktiviteteve të tjera, femrat mësonin të endnin dhe të qëndisnin tekstile prej leshit, pambukut dhe mëndafshit. Qilimat e rajonit të Prizrenit janë punuar në kuadër të artizanatit shtëpiak. Sot rrallë enden dhe përdoren qilimat, cergat dhe sixhadetë tradicionale. Në Sektorin Etnologjik të Kompleksit Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nga Prizreni janë ekspozuar pesë qilima, disa furka, një vek horizontal me pajisjet e tij, gërshërë, gjilpëra e madhe për qepje etj.

Në qilimat, strukat dhe sixhadetë e rajonit të Hasit të Prizrenit paraqiten motive zoomorfe /zogj, shqiponja, bretkosa/, motive gjeometrike /rombe të vogla, trekëndëshi, katrorë të vegjël/, motive kozmike /dielli dhe ylli me gjashtë cepa/, motivi i këmbanës, i filxhanit të kafesë, i hajmalisë, i krahnit etj.

Në këtë rajon gratë ende endin në vek, mirëpo kjo veprimtari artizanale dita më ditës po shuhet.

Në qilimat dhe sixhadetë e rajonit të Lumës dhe të Vrrinit paraqiten motive zoomorfe, florale, gjeometrike, kozmike dhe fetare. Shpesh këto motive janë të kombinuara.

Në këtë rajon, sot numri i grave që endin në vek është rralluar dukshëm. Ndër veglat për punimin e tekstit janë vekët, boshtet etj.

Në aspektin e artizanateve fshatrat Zhur dhe Vërmicë duhet të përfshihen në ringjalljen e këtij artizanati. Në Vërmicë si vend turistik me shumë vizitorë, është e nevojshme hapja e një shitoreje të artizanateve, ku gratë nga rajonet e Lumës, Vrrinit, Hasit të Prizrenit, Opojës dhe të Gorës do të shesin prodhimet e tyre si suvenire turistike. Ky aktivitet gjithashtu do të mundësoj ruajtjen e trashëgimisë etno - folklorike dhe zhvillimin e etno-turizmit.

Në Prizren dhe fshatrat e Komunës së tij shumë tekstile të endura, sidomos qilimat dhe çarçafët e shtratit janë djegur në luftën e fundit në Kosovë, gjatë viteve 1998 - 1999.

Në qilimat e rajonit të Opojës paraqiten kryesisht motivet florale, gjeometrike, zoomorfe dhe kozmike. Motivët florale janë në formë të luleve e të fletëve. Motivët gjeometrike janë në formë vijash në forma të ndryshme, të katrorit e të rombit. Ato i gjejmë në mbulesat e djepit, marhamat e duarve, çarçafët e shtratit etj. Motivët zoomorfe janë në formë të zogjve, të shqiponjës e të fluturës. Ato i gjejmë në marhamat e duarve dhe çarçafët e shtratit. Në fshatrat e rajonit



të Opojës sot rrallë përdoren tekstilet, ndërkaq gratë rrallë endin në vek pos ndonjë gruaje të moshuar. Në qilimat e rajonit të Gorës motivi i skematizuar i gjarprit paraqitet në formë të spirales e të vijave zigzage. Sot gratë akoma endin në vek qilima dhe sixhade, por numri i tyre është pakësuar dukshëm. Në qilimat dhe sixhadetë e Komunës së Suharekës motivet gjeometrike janë në formë të rombeve dhe të trekëndëshit. Motivët zoomorfe janë në formë të shqiponjës në formë natyrore dhe të stilizuar. Në qilimat e Komunës së Rahovecit gjejmë motivin e shqiponjës, motive gjeometrike në formë të rombeve, vijave dhe katrorëve, motive florale, motivin e ibrikut dhe motive të tjera. Në këtë Komunë akoma ekziston veprimtaria artizanale rreth endjes së pëlhurave në vek, por ajo gjithashtu është në shuarje e sipër. Në shtëpitë dhe kullat e Komunës së Malishevës janë evidencuar qilimat, mbulesat e krevatit, mbulesat e djepit, çarçafët dhe duqit. Pjesa dërrmuese e tyre, bashkë me vekët, janë djegur në luftën e fundit në Kosovë gjatë viteve 1998 - 99.

## CONCLUSION

Making of carpets is a well-known house craft of Prizren. During the 60/s in XIX century making of woolen carpets spread out quickly in Prizren.

Craftsmen school existed in the beginning of XX century in Prizren, where among the other activities women learnt to weave on the loom and textile embroidery of wood, cotton, and silk.

Carpets of Prizren Region were made as a homemade craft. Nowadays carpets, rugs of goat wool "cergat" and traditional rugs "sixhadetë" are rarely woven and used.

At Ethnological Sector of Monumental Complex of Albanian League of Prizren, from Prizren are exposed five carpets, some distaffs, a horizontal loom with its equipment, scissors, big needle for sewing etc.

On carpets, cradle covers and rugs of Has of Prizren Region are presented zoomorphic motives, such as; birds, eagles, frogs, geometric motives, small rhombs, triangles, small quadrangles, cosmic motives, sun and the star with six edges, motive of church bell, coffee put, charm, comb etc.

24 Woman in this region still weave on the loom, but this craft is being extinct day by day.

On carpets and rugs of Luma and Vrrini Region are

presented zoomorphic, floral, geometric, cosmic and religion motives. These motives are frequently combined. The number of women weaving on the loom is apparently reduced nowadays in this region.

Among the tools for manufacturing of textile are looms, spindles etc. Concerning artisan activities, the villages Zhur and Vërmicë should be included in revival of this artisan. In Vërmica as a tourist resort with a lot of visitors, there is a need for opening of an artisan shop, where women from the regions of Luma, Vrrini, Has of Prizren, Opoja and Gora will sell their products as tourist souvenirs. This activity will also enable preserving of ethno - folkloric tradition and develop ethno - tourism

In Prizren and its municipal villages many woven textiles, and particularly carpets and bed sheets were burnt in the last War in Kosovo during 1998 - 1999.

Floral, geometric, zoomorphic and cosmic motives are mainly introduced on carpets of Opoja Region.

Floral motives are in shape of flowers and leaves.

Geometric motives are in the forms of lines of different shapes, quadrangles and rhomb. Such motives may be found on cradle covers, handkerchiefs, bed sheets, etc. Zoomorphic motives are made in shape of birds, eagle and butterfly. They

may be found in handkerchiefs and bed sheets. In villages of Opoja Region textiles are rarely used nowadays, whereas women except for some old-aged woman rarely may be seen weaving on the loom.

On the carpets of Gora Region schematic motive of snake is presented in spiral and zigzag form. Women nowadays still weave carpets and rugs on the loom, though this artisan is apparently vanishing.

On the carpets and rugs of Suhareka Municipality, geometric motives are presented in shapes of rhombs and triangles. Zoomorphic motives are presented in shape of eagle in natural and stylistic form.

On the carpets of Rahovec Municipality we may find motives of eagle, geometric motives of rhomb shapes, lines and quadrangles, floral, motive of jug and other motives. In this municipality artisan activity of textile weaving on the loom still exists, but is also vanishing.

Carpets, bed covers, cradle covers, bed sheets and saddle - bags are recorded in houses and fortified houses "kullas" of Malisheva Municipality. Most of them along with looms were burnt in the last War in

## LEGJENDAT - LEGENDS

### I. RAJONI I PRIZRENIT - REGION OF PRIZREN

#### 1. CERGE, QILIMA DHE PËRPARËSE, KOMUNA E PRIZRENIT

#### **RUGS , CARPETS , APRONS AND BAGS , MUNICIPALITY OF PRIZREN**

1. Cerge, endur me fije leshi të dhisë, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë

Rug of woven goats wool, the beginning of the XX-th century, Prizren, Kosova

2. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th century, Prizren, Kosova

3. Fragment i mesit dhe i bordurave të qilimit, endur me fije leshi shumëngjyrësh, fundi i shekullit XIX, Prizren, Kosovë

Fragment of carpets mid and border, made of multicolored wool, the end of the XIX-th century, Prizren, Kosova

4. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th century, Prizren, Kosova

5. Fragment i bordurave të qilimit, fundi i shekullit XIX, Prizren, Kosovë

Fragment of carpets border, the end of the XIX-th century, Prizren, Kosova

6. Qilim i endur, fundi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the end of the XIX-th century, Prizren, Kosova

7. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th century, Prizren, Kosova

8. Qilim me motivin e shqiponjës, fillimi i shekullit XX,  
Prizren, Kosovë  
Eagle motive carpet, the beginning of the  
XX-th century, Prizren, Kosova
9. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
10. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
11. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
12. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
13. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
14. Qilima me motive gjeometrike dhe zoomorfe,  
fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Geometrical and zoomorph motive carpets,  
the beginning of the XX-th century,  
Prizren, Kosova
15. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
16. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Prizren, Kosovë  
Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Prizren, Kosova
17. Veku, Prizren, Kosovë  
A loom, Prizren, Kosova
18. Çantë e endur, Prizren, Kosovë  
Woven bag, Prizren, Kosova

## 2. PËRPARËSET, RAJONI I HASIT TË PRIZRENIT

### **APRONS, REGION OF HAS OF PRIZREN**

1. Përparëse gruaje, varianti katolik, fillimi i shekullit XX, Zym, rajoni i Hasit të Prizrenit

Woman apron, Catholic version, the beginning of the XX-th century, Zym, Region of Has of Prizren

2. Përparëse gruaje, varianti katolik, fillimi i shekullit XX,

Zym, rajoni i Hasit të Prizrenit

Woman apron, Catholic version, the beginning of the XX-th century, Zym, region of Has of Prizren

3. Përparëse gruaje me motive florale, varianti mysliman, fillimi i shekullit XX, Gjonaj, rajoni i Hasit të Prizrenit

Floral motive woman's apron, Moslem version, the beginning of the XX-th century, Gjonaj, region of Has of Prizren

4. Përparëse gruaje, varianti mysliman, fillimi i shekullit XX, Gjonaj, rajoni i Hasit të Prizrenit

Woman apron, Moslem version, the beginning of the XX-th century, Gjonaj, region of Has of Prizren

## 3. QILIMA DHE PËRPARËSE, RAJONI I LUMËS

### **CARPETS AND APRONS, REGION OF LUMA**

1. Qilima me motive florale dhe zoomorfe, fillimi i shekullit XX, rajoni i Lumës, Prizren, Kosovë  
Floral and zoomorph motive carpets,

2. Përparëse gruaje, fillimi i shekullit XX, Zhur, rajoni i Lumës, Prizren, Kosovë  
Woman apron, the beginning of the XX-th century, Zhur, region of Luma, Prizren, Kosova

#### 4. QILIMA DHE PËRPARËSE, RAJONI I ZHUPËS

##### **CARPETS AND APRONS, REGION OF ZHUPA**

1. Qilima të vegjël, fillimi i shekullit XX, rajoni i Zhupës, Prizren, Kosovë  
Small carpets, the beginning of the XX-th century, region of Zhupa, Prizren, Kosova
2. Përparëse gruaje, fillimi i shekullit XX, rajoni i Zhupës, Prizren, Kosovë  
Woman apron, the beginning of the XX-th century, region of Zhupa, Prizren, Kosova
3. Qilim i vogël, fillimi i shekullit XX, rajoni i Zhupës, Prizren, Kosovë  
Small carpet, the beginning of the XX-th century, region of Zhupa, Prizren, Kosova
4. Veku, rajoni i Zhupës, Prizren, Kosovë  
A loom, region of Zhupa, Prizren, Kosova

#### II. QILIMA DHE PËRPARËSE, KOMUNA E DRAGASHIT

##### **CARPETS AND APRONS, MUNICIPALITY OF DRAGASH**

- 30 1. Qilim i endur, rajoni i Opojës, komuna e Dragashit  
Woven carpet, region of Opojë, Municipality of Dragash
2. Qilim i endur, rajoni i Opojës, komuna e Dragashit



Woven carpet, region of Opojë, Municipality  
of Dragash

3. Qilima të endur, fillimi i shekullit XX, rajoni i Gorës,  
Komuna e Dragashit

Woven carpets, the beginning of the XX-th  
century, region of Gora, Municipality of  
Dragash

4. Qilima të endur, fillimi i shekullit XX, rajoni i Gorës,  
Komuna e Dragashit

Woven carpets, the beginning of the XX-th  
century, region of Gora, Municipality of  
Dragash

5. Përparëse gruaje, fillimi i shekullit XX, rajoni i Gorës,  
Komuna e Dragashit

Woman apron, the beginning of the XX-th  
century, region of Gora, Municipality of  
Dragash

### **III. QILIMA, KOMUNA E SUHAREKËS CARPETS, MUNICIPALITY OF SUHAREKA**

1. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Leshan, Komuna e  
Suharekës, Kosovë

Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Leshan, Municipality of Suhareka,  
Kosova

2. Qilim i endur, fillimi i shekullit XX, Leshan, Komuna e  
Suharekës, Kosovë

Woven carpet, the beginning of the XX-th  
century, Leshan, Municipality of Suhareka,  
Kosova

### **IV. QILIMA, KOMUNA E MALISHEVËS CARPETS, MUNICIPALITY OF MALISHEVA**

1. Qilima të endur, Komuna e Malishevës, Kosovë

Woven carpets, Municipality of Malisheva,  
Kosova

## **V. QILIMA, KOSOVË - CARPETS, KOSOVA**

1. Qilim me motivin e shqiponjës, fillimi i shekullit XX,  
Kosovë

Eagle motive carpet, the beginning of the  
XX-th century, Kosova

2. Qilim me motive florale, fillimi i shekullit XX, Pejë,  
Kosovë

Floral motive carpet, the beginning of the  
XX-th century, Peja, Kosova

3. Qilim me motive florale, fillimi i shekullit XX, Pejë,  
Kosovë

Floral motive carpet, the beginning of the  
XX-th century, Peja, Kosova

## **VI. PËRPARËSE, MAQEDONI APRONS, MACEDONIA**

1. Përparëse gruaje, fillimi i shekullit XX, Kumanovë,  
Maqedoni

Woman apron, the beginning of the XX-th  
century, Kumanova, Macedonia

## **VII. QILIMA DHE PËRPARËSE, SHQIPËRI CARPETS AND APRONS, ALBANIA**

1. Qilim i endur, Muzeu etnografik i Gjirokastrës  
Woven carpet, Ethnographic Museum Of  
Gjirokastra

32

2. Përparëse gruaje, Muzeu etnografik i Pukës,  
Shqipëri

Woven apron, Ethnographic Museum of Puka,

## Përmbajtja - Content

- 3 Parathenie
- 4 Preface
- 5 Qilimat e Komunës së Prizrenit
- 12 Qilimat e Komunës së Dragashit
- 13 Qilimat e Komunës së Suharekës
- 14 Qilimat e Komunës së Rahovecit
- 15 Qilimat e Komunës së Malishevës
- 17 Ilustrimet
- 21 Përfundimi
- 24 Conclusion
- 27 Legjendat - Legends



Shpresë Siqeca

BOTA MAGJIKE  
E QILIMAVE TË PRIZRENIT

MAGIC WORLD  
OF PRIZREN CARPETS

Përkthimi në anglisht - Translation in English:  
Ramadan Berisha

Shtypi - Press:  
Europrinty - Prishtinë





